



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Senati Akademik

Nr. 4127 prot.

Shkodër, më 19.12.2022

V E N D I M

Nr. 264, datë 19.12.2022

"PËR PËRCAKTIMIN E LLOGARITJES SË NOTËS MESATARE PËR EFEKT TË REDUKTIMIT TË TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT NË MASËN 50% "

Në mbështetje të ligjit nr.80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 3 gërma ç, neni 6 pika 30, neni 38,49, VKM-së nr. 288, datë 21.05.2018 "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në Institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, me kohë të plotë", (i ndryshuar me VKM nr. 723, datë 06.12.2018, si dhe VKM nr. 778 datë 26.12.2018), Statutit të USH-së, neni 5, neni 17, pika 6 gërma nj, Senati Akademik në mbledhjen e datës 19.12.2022,

Vendosi

1. Të përcaktojë, për efekt zbatimi, që përfitues të reduktimit në masën 50% të tarifës vjetore të shkollimit, në ciklin e parë të studimeve, në një program të integruar, apo në një program profesional do të jenë ata studentë të cilët në përfundim të vitit të parë e në vijim kanë arritur pikët ECTS të nevojshme për kalimin në vitin pasardhës dhe rezultojnë me notë mesatare të ponderuar mbi 6. Tek kjo mesatare do të llogaritet mesatarja e ponderuar e detyrimeve me notë kaluese të vitit paraardhës, pavarërisht detyrimeve të pashlyera.
2. Nota mesatare do të llogaritet duke marrë për bazë vetëm notat kaluese të lëndëve bija (moduleve të veçanta).
3. Të merret për bazë nota mesatare e ponderuar e llogaritur nga sistemi PITAGORA, në përfundim të vitit të parë e në vijim, pas aplikimit të kalueshmërisë në vitin pasardhës.
4. Drejtoria ekonomike të marrë për bazë evidencën e sistemit PITAGORA me notën mesatare të ponderuar për çdo student të rregullt, të vitit akademik në të cilin do të aplikohet kjo mesatare.
5. Evidenca vihet në dispozicion nga RASH-i pas aplikimit të kalueshmërisë në vitin pasardhës.
6. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr. Suzana GOLEMI



